



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 57

Tiranë – E enjte, 2 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 2.4.2020	Për një shtesë në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar..... 3337
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 2.4.2020	Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19..... 3337
Vendim i Komitetit Ndërmnisror të Emergjencave Civile nr. 5, datë 1.4.2020	Për një shtesë në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar..... 3338
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr .2955/1, datë 1.4.2020	Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, për zonën 1/1, njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë..... 3340



AKT NORMATIV
Nr. 12, datë 2.4.2020

PËR NJË SHITESË NË AKTIN
NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIU DHËS SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 19, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

“20. Të gjithë qiramarrësit individë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, që kanë kontratë pune por e kanë pezulluar/zgjidhur atë si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit studentë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit persona fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, dhe e kanë ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin, pas muajit

maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit e përcaktuar në këtë pikë, të cilët kanë ankesë për qiradhënësin si pasojë e moszbatimit të detyrimeve të mësipërme, do t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet komunikimit elektronik.

Qiradhënësit, të cilët nuk e zbatojnë këtë pikë, dënohen me gjobë në masën e pesëfishit të qirasë mujore përkatëse.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ndjekjen dhe zbatimin e parashikimeve të kësaj pike dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV
Nr. 13, datë 2.4.2020

PËR MARRJEN E MASAVE TË
VEÇANTA NË FUSHËN E
VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT
PËRMBARIMOR GJYQËSOR,
NDËRMJETËSIMIT DHE
ADMINISTRIMIT TË PROCEDURAVE
TË FALIMENTIMIT GJATË
KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA
COVID-19

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky akt normativ ka për objekt përcaktimin e masave të veçanta për kryerjen e veprimtarisë së



shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror dhe privat, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

Neni 2

Qëllimi

Ky akt normativ ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve që mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror dhe privat, ndërmjetësimit apo administrimit në procedurat e falimentimit, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

Neni 3

Masat e veçanta në fushën e shërbimit përbarimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe falimentit

1. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të përbaruesit gjyqësor shtetëror apo privat, ndërmjetësit dhe administratorit në procedurat e falimentimit. Kur afatet për kryerjen e veprimeve procedurale sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

2. Rregullat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, nuk zbatohen në këto raste:

a) Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë që rrjedhin nga çështje familjare, me objekt kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë, birësimin, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, perkujdesjen dhe detyrimet për ushqim;

b) Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes;

c) Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt masat e sigurimit të padisë për çështje administrative dhe për çështjet civile, në të cilat gjykata ka dhënë vendim për sigurimin e padisë ose vendim me ekzekutim të përkohshëm, kur nga vonesa e ekzekutimit ose e kryerjes së veprimeve procedurale bëhet i pamundur ekzekutimi i këtyre

titujve ekzekutivë, pas përfundimit të gjendjes së epidemisë;

ç) Nëse është e domosdoshme shmangia e dëmtimit të masës së falimentimit;

d) Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur gjatë hetimit vlerësohet si e nevojshme për mbrojtjen e interesave të të miturit.

3. Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19, në funksion të zbatimit të rregullave nënligjore të nxjerra nga organet përgjegjëse shtetërore, organet e shërbimit përbarimor shtetëror dhe privat, të ndërmjetësve dhe administratorëve të falimentimit, në të gjitha rastet, marrin masa organizative të posaçme për të shmangur grumbullimet, kontaktet e ngushta ndërmjet individëve, si dhe praninë e publikut në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të përbaruesit gjyqësor, ndërmjetësit dhe administratorit të falimentimit.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 5, datë 1.4.2020

PËR NJË SHITESË NË AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 1.4.2020,



VENDOSI:

1. Pas pikës 19, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

“Të gjithë qiramarrësit individë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, që kanë kontratë pune por e kanë pezulluar/zgjidhur atë si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit studentë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit persona fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, dhe e kanë ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin, pas muajit maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit e përcaktuar në këtë pikë, të cilët kanë ankesë për qiradhënësin si pasojë e moszbatimit të detyrimeve të mësipërme, do t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet komunikimit elektronik.

Qiradhënësit, të cilët nuk e zbatojnë këtë pikë, dënohen me gjobë në masën e pesëfishit të qirasë mujore përkatëse.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ndjekjen dhe zbatimin e parashikimeve të kësaj pike dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.”

2. Miratimin, në parim, të projektaktit normativ të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta

administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTOROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV

Nr. _____, datë _____

**PËR NJË SHITESË NË AKTIN
NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 19, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

“20. Të gjithë qiramarrësit individë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, që kanë kontratë pune por e kanë pezulluar/zgjidhur atë si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit studentë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër



që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit persona fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, dhe e kanë ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin, pas muajit maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit e përcaktuar në këtë pikë, të cilët kanë ankesë për qiradhënësin si pasojë e moszbatimit të detyrimeve të mësipërme, do t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet komunikimit elektronik.

Qiradhënësit, të cilët nuk e zbatojnë këtë pikë, dënohen me gjobë në masën e pesëfishit të qirasë mujore përkatëse.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ndjekjen dhe zbatimin e parashikimeve të kësaj pike dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË

Nr .2955/1, datë 1.4.2020

PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, për zonën 1/1, njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si:

1. Për pasurinë e llojit "tokë arë" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministarve “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Për “kulturat bujqësore” është bërë në referencë të udhëzimit nr.1, datë 5.10.2000 “Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”;

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 15 910 549 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e dhjetë mijë e pesëqind e dyzetë e nëntë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE
SHKËMBIMIT
Artan Shkreli



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, DHE/OSE PËR SHKËMBIM, PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR "PËR ZONËN 1/1, NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË"

Nr.	STATUSI JURIDIK			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-Kruje)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË					Dokumenti i Pronësisë	Kompensim (lekë)	Çështje Gjyqësore të hapura	SHËNIME
	PRIVAT			Zona Kadastrale	Nr.	Lloji	Sip.	Shpronësim tokë "arë"			Vegjetacioni	VLERA				
	Emri	Atësia	Mbiemri		Totale	Sip.	Çmimi	Vlera	Vlera	TOTALE						
						(m2)	(m2)	(lekë/m2)	(lekë)	(lekë)	(lekë)					
PRONË PRIVAT																
1	MEREME	TARE	ZIRA	3599-THUMANË	12/3	ARË	2800	2800	442	1,237,600		1,237,600	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	1,237,600		
2	NEZIR	ADEM	ZIRA	3599-THUMANË	12/2	ARË	1400	1400	442	618,800	348,529	967,329	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	967,329		
3	NAFIE ALMA EGLANTINA TEUTA ALFRED SONILA KLEVIS	SALI ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL	ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA	3599-THUMANË	25/2	ARË	3080	3080	442	1,361,360		1,361,360	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	1,361,360		
4	SABA	ADEM	ZIRA	3599-THUMANË	53/6	ARË	2300	2300	442	1,016,600		1,016,600	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	1,016,600		Përshkrimi i veçantë: Sek. Kons. Dt.28.08.2017, N.822276 "FS" shpk
5	ASTRIT	ADEM	ZIRA	3599-THUMANË	53/5	ARË	2300	2300	442	1,016,600		1,016,600	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	1,016,600		
6	ZIM	NEZIR	ZIRA	3599-THUMANË	53/4	ARË	1550	1550	442	685,100		685,100	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	685,100		
7	NAFIE ALMA EGLANTINA TEUTA ALFRED SONILA KLEVIS	SALI ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL	ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA	3599-THUMANË	53/3	ARË	2040	2040	442	901,680		901,680	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	901,680		
8	MEREME	TARE	ZIRA	3599-THUMANË	53/1	ARË	5620	5620	442	2,484,040		2,484,040	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	2,484,040		
9	BANKA E TIRANES SHA			2182-KODËR THUMANË	122/3	ARË	6000	6000	362	2,172,000	90,240	2,262,240	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	2,262,240		Kalim i pronësisë me përmbarim
10	XHAFER	MUSTAFA	NUZI	3599-THUMANË	122/2	ARË	9000	9000	442	3,978,000		3,978,000	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	3,978,000		
Kompensimi (Lekë)							36,090	36,090		15,471,780	438,769	15,910,549		15,910,549		
PRONË SHITET																
11	SHITET			3599-THUMANË	12/4	ARË	5050	5050		-		-	Kartela e Pasurisë			Mbi pasurinë nr.



											së Paluajtshme			12/4 gjendet ndërtesë me sipërfaqje 228 m², e ngritur në vitin 2010 në Kodër Thumanë, në emër të vetëdeklaruesit Kastriot Nikoll Legisi, e cila sipas Vendimet nr....., date të ASHK, Drejtoria Vendore Krujë, përjashtim nga legalizimi.
12	SHTET	3599-THUMANË	12/6	ARË	2300	2300		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			
13	SHTET	3599-THUMANË	25/1	ARË	4100	4100		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			
14	SHTET	3599-THUMANË	26	ARË	8270	8270		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			
15	SHTET	3599-THUMANË	53/2	ARË	1650	1650		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			
16	SHTET	2182-KODËR THUMANË	122/1	ARË	3000	3000		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			Akti 108, dt.31.01.1997, Tipi: Përdorim, Aben Vath Uka.
17	SHTET	2182-KODËR THUMANË	123	KULLOTË	9100	4560		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			
18	SHTET	3599-THUMANË	50/2	VRESHTË	10800	310		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr.50/3, vol.8, fq.171 dhe ndërtesa nr.50/4, vol.8, fq.220 Ndertesat mbi kete pasuri ndodhen ne pjesen e parceles qe nuk preket nga projekti (ndodhen jashte gjurmes se projekti).
19	SHTET	3599-THUMANË	51/15	ARË	32350	10775		-		-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme			Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr.51/27, vol.8, fq.210; ndërtesa nr.51/28, vol.8, fq.220 dhe ndërtesa nr.51/29, vol.8, fq.221. Keto ndertesat jane jashte zones se projektit. Ndertesat mbi kete pasuri ndodhen ne pjesen



													e parceles qe nuk preket nga projekti (ndodhen jashte gjurmes se projekti). Gjithashtu mbi këtë pasuri ndodhet objekti i llojit stallë, me sipërfaqje 119 m², e ngritur në vitin 1998, në emër të vetëdeklaruesit Saba Adem Zira, i cili sipas Vendimet nr....., date të ASHK, Drejtoria Vendore Krujë, përjashtim nga legalizimi.
20	SHTET	3599-THUMANË	161	KANAL	2900	2900				-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme		
21	SHTET	2182 - KODER THUMANE	359	KANAL	3000	3000				0	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme		
Totali për pronën shtet					82,520	45,915							
TOTALI PARAPRAK Kompensimi (Lekë)						82,005		-	-	-		15,910,549	

Shënime:

1. Për vlerësimin e pasurisë të llojit "tokë arë", çmimi i llogaritur është marrë nga VKM Nr.89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"
2. Vlerësimi për kulturat bujqësore është bërë në referencë të Udhëzimit nr.1, datë 05.10.2000 "Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë